



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETAR

8380  
Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Shkodër, më 19.4.2024

DËRGIM PROJEKT - VENDIM DHE RELACION

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë !

Bashkangjitur ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shpjegues " Për shtesë në buxhetin ee vitit 2024 e miratuar me Vendimin e Këshillit bashkiak nr. 55, datë 29.12.2023 "për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër"

Duke ju uruar punë të mbarë !

Me respekt

KRYETAR

BENET BECI

ME VENDIM DELEGIMI

KRYETAR  
ONID BEJLERI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KRYETAR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Shkodër, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2024

**PROJEKT- VENDIM**

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2024 E MIRATUAR ME “VENDIMIN E  
KËSHILLIT BASHKIAK NR.55 DATË 29.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË  
VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024 –  
2026 TË BASHKISË SHKODËR”**

Këshilli i Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_,2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, neni 54 shkronja “dh” ; ligji nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, VKM nr.414 datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile” i ndryshuar, neni 3,3.1, gërmat a,b,dh, ligji nr.68/2017 “Për financat vendore” i ndryshuar, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar ; shkresës nr.4461/2 prot. datë 20.02.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” të Ministrisë së mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”; shkresës nr.3680/1 prot. datë 23.02.2024 “Kthim përgjigje Ministrisë së Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile te shkresës me nr. 446/2 prot. datë 20.02.2024 me objekt “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” nga Bashkia Shkoder ; shkresës nr.3806/1 datë 29.03.2024 prot. “Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2024” të Ministrisë së Financave VKB nr. 55 , datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër“ , i ndryshuar , dhe “Relacionin e paraqitur nga administrata e Bashkisë Shkodër nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_ ,

**VENDOSI :**

**I.** Të miratojë shtesën e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024 alokuar në programin 10910 “Emergjencat Civile” art.604 prej **22,879,560 lekë** si më poshtë:

1.Për kod produkti 91707AG – “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me vlerë **10,000,000 lekë**.

2.Për kod produkti 91707AB – “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” me vlerë **12,879,560 lekë**.

**II.** Të miratojë shpenzimet për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me kod produkti 91707AG me vlerë **10,000,000 lekë** si më poshtë:

1-“Shërbime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë si rezultat i fenomeneve natyrore” me vlerë **2,000,000 lekë**

2-“Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësi Administrative, Bashkia Shkodër” me vlerë **4,000,000 lekë**


3-“Blerje materiale inerte për mbrojtjen e argjaturave dhe infrastrukturës nga fenomeneve natyrore” me vlerë **1,000,000 lekë**.

4- “Blerje material për riparimin e urave në Njësitë Administrative me vlerë **500,000 lekë**.

5-“Blerje koncentrat për blegtorinë” në shumën **2,500,000 lekë**.

**III.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**IV.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.



**KRYETAR  
Benet BECI**

**Njesia e Emergjencave dhe Mbrojtjes Civile.**

Isakë Hadrutashaj

**9/ Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe AMTP**

Enton Dedaj

**Drejtoria e Analizës dhe Programimit Buxhetor**

Arb Hexhaj

**Drejtoria e Financës**

Blerta Njoku

**Drejtoria Juridike**

Hazelina Prigori



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR**  
**SEKTORI I MBROJTJES SË EMERGJENCAVE CIVILE**

Nr. \_\_\_\_ Prot

Shkodër, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

**RELACION**

**“PËR SHITESË NË BUXHETIN E VITIT 2024 E MIRATUAR ME “VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.55 DATË 29.12.2023 “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2024 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR 2024 – 2026 TË BASHKISË SHKODËR”**

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

Të nderuar Këshilltarë,

Me shkresën nr.4461/2 prot. datë 20.02.2024 “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” të Ministrisë së mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, është kërkuar ndarja e fondit të miratuar në masën 21,371,526.16 lekë.

Me shkresën nr.3680/1 prot. datë 23.02.2024 “Kthim përgjigje shkresës me nr. 446/2 prot. datë 20.02.2024 me objekt “Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile” të Ministrisë së Mbrojtjes, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, Bashkia Shkodër ka bërë detajimin e fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2024 si më poshtë:

1. Për Kod produkti 91707AG – “Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve” me vlerë **10,000,000 lekë**.
2. Për Kod produkti 91707AB – “Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme” me vlerë **12,879,560 lekë**.

Propozojmë miratimin e shtesës së fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile për vitin 2023 në vlerën **22,879,560 lekë**

Me shkresën nr.3806/1 datë 29.03.2024 prot. “Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2024” të Ministrisë së Financave është akorduar fondi prej **22,879,560 lekë**.

Në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", VKM nr 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve ndërtimore të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKM nr.414 datë 08.07.2021 "Për miratime procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondeve të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile" i ndryshuar, neni 3.3.1, gërmat a,b,dh, ligji nr.68/2017 "Për financat vendore" i ndryshuar, , Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar ; shkresës nr.4461/2 prot. datë 20.02.2024 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" të Ministrisë së mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile"; shkresës nr.3680/1 prot. datë 23.02.2024 "Kthim përgjigje Ministrisë së Mbrojtjes, Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile te shkresës me nr. 446/2 prot. datë 20.02.2024 me objekt "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile" nga Bashkia Shkoder ; shkresës nr.3806/1 datë 29.03.2024 prot. "Dërgohet miratimi për shpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile viti 2024" të Ministrisë së Financave "VKB nr. 55 , datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të Bashkisë Shkodër" , i ndryshuar, ju paraqesim propozimet si më poshtë:

a. "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme" me vlerë **12,879,560 lekë**. Ky fond të jetë gjëndje për përbalimin e dëmeve të vlerave ndërtimore dhe orendive deri në masën 50% të vlerës së dëmit për raste të paparashikuara, si dhe për raste të tjera të paparashikuara për emergjencat civile gjatë vitit 2024.

b. "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve" me vlerë **10,000,000 lekë**.

Ky fond propozojmë të detajohet si më poshtë:

**1- "Shërbime emergjente për riparimin e dëmeve të shkaktuara në infrastrukturë si rezultat i fenomeneve natyrore" në shumën 2,000,000 lekë**

Nisur nga eksperiencat e viteve të kaluara, si rezultat i rreshjeve të shumta gjatë stinëve vjeshtë e dimër, rrjeti rrugor kryesisht rural ku prurjet e shumta nga shirat e rrëmbyer dhe inertet që vijnë nga shpatet gërryejnë trupin e rrugës duke vështirësuar qarkullimin dhe rrezikuar kalimin e mjeteve në rrugët rurale. Që rruga të arrijë nivelin e kërkuar të sigurisë për përdoruesit e saj kërkohet ndërhyrje për pastrimin e tyre dhe riparime emergjente me mjete gërmuese, niveluese e transportuese

**2- "Shërbime për mirëmbajtje emergjente të rrugëve të Qytetit dhe Njësi Administrative, Bashkia Shkodër" me vlerë 4,000,000 lekë**

*-"Dispozicion dy borëpastruese për punime hapje rruge nga bora, në raste emergjencash"*

*-"Dispozicion fadromë për punime hapje rruge në raste emergjencas"*

Me këtë shpenzim parashikojmë shërbimin me mjete përbalimin e nevojave për mbrojtje dhe përmirësim të infrastrukturës rrugore nga pasojat e rreshjeve në rrugë urbane dhe rurale.

Këto mjete të specializuara janë parashikuar të ndërhyjnë në rrugët e qytetit dhe të njësive administrative fushore, për të bërë të mundur pastrimin e borës dhe materialeve të ndryshme në mënyrë që të sigurohen kushtet e qarkullimit në një kohë sa më të shpejtë të njerëzve dhe mjeteve.

Dispozicion eskavator 0.35-0.4 m3 për punime hapje rruge në raste emergjencash

Dispozicion Fadromë për punime hapje rruge në raste emergjencash

Me këto mjete janë parashikuar ndërhyrjet për hapjen e rrugëve të njësive administrative Postribë-Pult – Shosh-Shalë. Punimet e parashikuara janë zhblokimi i rrugëve nga dëbora në të gjithë aksin si dhe hapjen e rrugëve dhe riparimin e pasojave nga rreshqitjet e materialeve si gurë, dhera etj.

Me këto masa do të sigurohet ndërhyrja në kohë për mbajtjen në gjendje sigurie të rrugëve dhe për të bërë të mundur krijimin e kushteve të lëvizjes të sigurtë për banorët e këtyre zonave.

### **3-“Blerje materiale inerte për mbrojtjen e argjaturave dhe infrastrukturës nga fenomeneve natyrore” me vlerë 1,000,000 lekë.**

Me këtë fond parashikohet blerja e materialeve për ti paraprirë situatave të pritshme nga fenomeneve natyrore me qëllim reduktimin e pasojave në rast të paparashikuara.

### **4- Blerje material për riparimin e të urave në Njësitë Administrative me vlerë 500,000 lekë.**

Me këtë fond parashikohet blerja e materialeve për riparimin e urave të këmbësorëve në Njësitë Administrative ti paraprirë situatave të pritshme nga fenomeneve natyrore me qëllim reduktimin e pasojave në rast të paparashikuara.

### **5-“Blerje koncentrat për blegtorinë” në shumën 2,500,000 lekë**

Situatat emergjente kryesisht nga përmytjet, krijojnë probleme të mëdha në sigurimin e bazës ushqimore për blegtorinë. Për ti paraprirë këtyre situatave propozojmë të realizohet blerja e koncentratit për blegtorinë. Me fondin e propozuar parashikohet blerja koncentrat për gjedhë, të imëta dhe derra.

Sa më sipër kërkojmë nga ana juaj miratimin e propozimeve të paraqitura.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

**KRYETAR  
Benet BECI**



*Onid Bejleri*  
*Bejleri*